

Trupi koordinues për edukim financiar dhe përfshirje financiare



KODI

I PRAKTIKAVE TË MIRA PËR EDUKIM FINANCIAR

Gusht, 2021

Bazuar në Strategjinë për edukim financiar dhe përfshirje financiare të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021 - 2025, e miratuar me Deklaratë për pranimin e Strategjisë më 8.7.2021 me nr. 02-20910/1 nga institucionet rregullatore financiare, Trupi koordinues për edukim financiar dhe përfshirje financiare në mbledhjen e datës 27.8.2021 miratoi

KODIN E PRAKTIKAVE TË MIRA PËR EDUKIM FINANCIAR

Hyrje

Qëllimi kryesor i Kodit të praktikave të mira për edukim financiar (në tekstin e mëtejshëm: Kodi) është promovimi dhe zbatimi i edukimit financiar të paanshëm me cilësi të lartë nga të gjitha subjektet e përfshira. Në kushte moderne të sistemit financiar dinamik, edukimi financiar bëhet i nevojshëm për të gjitha grup - moshat dhe të gjitha shtresat shoqërore të popullatës. Nga pikëpamja e institucioneve që kontribuojnë në këtë fushë, edukimi financiar bëhet pjesë e përgjegjësisë së tyre shoqërore dhe një aspekt i rëndësishëm në ndërtimin e reputacionit të tyre.

Duke marrë parasysh nevojat në rritje, iniciativat për edukim financiar po rriten vazhdimisht, gjithashtu edhe numri i subjekteve të përfshira nga sektori publik, privat dhe civil, prandaj nevojitet të përcaktohen bazat dhe mënyrat për përfshirjen e tyre, duke shmangur të gjitha konfliktet e mundshme të interesit. Aspekt i rëndësishëm është edhe koordinimi i subjekteve të përfshira, si dhe sigurimi i programeve arsimore efektive që janë në interes të popullatës.

Me qëllim të zbatimit të edukimit financiar cilësor dhe të paanshëm, ky Kod përcakton një sërë parimesh ose praktikash të mira, të cilat pritet të pranohen vullnetarisht nga institucionet që zhvillojnë iniciativa të edukimit financiar. Ky Kod, në thelb ndjek rekomandimet dhe praktikat e mira për edukim financiar të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Rrjeti Ndërkombëtar i Edukimit Financiar në OECD (INFE-OECD).

I. QËLLIMI

Ky dokument përcakton parimet që aplikohen gjatë zbatimit të iniciativave për edukim financiar të popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në mënyrë që të sigurohet korniza e nevojshme e paanshmërisë, cilësisë dhe transparencës.

II. FUSHËVEPRIMI

Iniciativat për edukim financiar iu referohen aktiviteteve që synojnë qëllimet e mëposhtme:

A. Përmirësimin e të kuptuarit nga ana e popullatës për produktet dhe shërbimet financiare si dhe përdorimin e tyre, njohje më të mirë të koncepteve dhe rreziqeve financiare;

B. Zhvillimin e aftësive të nevojshme dhe ndërgjegjësimit tek popullata për rreziqet dhe mundësitë financiare, përmes informimit, edukimit dhe/ose këshillave objektive nga subjektet përkatëse;

C. Zhvillimin e aftësive për të marrë vendime financiare mirë të informuara;

Ç. Zhvillimin i shprehive për kursim, planifikimin e shpenzimeve dhe mbrojtjen nga rreziqet financiare.

"Iniciativa për edukim financiar" nënkupton një aktivitet, materiale edukative ose burime në një format të përshtatshëm të zhvilluar nga institucionet e përcaktuara në pjesën e III më poshtë, në mënyrë që të arrihen objektivat e lartpërmendura (A-Ç). Ndër të tjera, iniciativat për edukim financiar mund të përfshijnë: ligjërata edukative, punëtori, seminare, uebinare, përmbajtje edukative në uebfaqe, broshura edukative, video dhe lojëra edukative, manuale ose udhëzime në këtë fushë. Trajnimi i profesionistëve aktualë ose të ardhshëm të sektorit financiar (trajnim profesional, trajnim i specializuar) ose trajnim akademik për çështjet financiare nuk konsiderohen një nismë për edukim financiar.

III. FUSHA E APLIKIMIT (Ofrues të edukimit financiar)

Ky Kod iu referohet institucioneve publike, private (fitimprurëse) dhe jofitimprurëse ose organizata të shoqërisë civile të interesuara për të ofruar edukim financiar, në veçanti për:

- Institucionet që ofrojnë shërbime financiare, siç janë: bankat, shtëpitë e kursimeve, kompanitë e sigurimeve, kompanitë për sigurime-brokerim, kompanitë e përfaqësimit të sigurimeve, bursat, depozituesit, kompanitë e menaxhimit të fondeve për investim, shtëpitë e brokerimit, kompanitë e pensioneve, fondet e kompanive të menaxhimit me pensione, kompanitë financiare;
- Qendrat e trajnimit ose kompani konsulence që ofrojnë edukim financiar si produkt ose shërbim brenda veprimtarisë të tyre;
- Institucionet jofitimprurëse të lidhura me sektorin financiar, siç janë shoqatat;
- Institucionet jofitimprurëse që nuk janë të lidhura me sektorin financiar, por kanë interes të organizojnë dhe ofrojnë edukime financiare, si organizatat joqerveritare, shoqatat e konsumatorëve, grupet e mësuesve ose institutet hulumtuese etj.

IV. PARIMET që përdoren gjatë zbatimit të iniciativave dhe aktiviteteve për edukim financiar

Ofruesit e edukimit financiar duhet t'iu përmbahen parimeve të mëposhtme kur zbatojnë iniciativat dhe aktivitetet e edukimit financiar:

- Parimi i paanshmërisë

Iniciativat dhe aktivitetet e edukimit financiar duhet të ofrojnë edukim dhe informacion objektiv, të paanshëm dhe pa paragjykitime. Ofruesit e edukimit financiar nuk duhet të përdorin iniciativa të tilla për qëllime komerciale, si pjesë e fushatave të

marketingut ose reklamave. Prandaj, prioritet i jepet interesave dhe nevojave për arsimim të popullatës. Ofruesit e shërbimeve nuk duhet ti përdorin iniciativat dhe aktivitetet për edukim financiar për të promovuar produktet dhe shërbimet e tyre dhe/ose për të kritikuar ato të konkurrentëve të tyre.

➤ Parimi i saktësisë

Iniciativat për edukim financiar ofrojnë informacion të qartë, të besueshëm, të saktë, të plotë, të përshtatshëm rreth temave të cilat i mbulojnë.

➤ Parimi i transparencës

Iniciativat dhe aktivitetet për edukim financiar duhet të sigurojnë informacion transparent rreth temës që e mbulojnë. Në këtë kontekst, duhet të theksohen pikëpamjet e ndryshme përkatëse në mënyrë që të sigurohet qasje e paanshme ndaj temës.

V. PËRMBAJTJA E INICIATIVAVE PËR EDUKIM FINANCIAR

➤ Objektivat

Iniciativat dhe aktivitetet për edukim financiar duhet të kenë qëllime të qarta, të përcaktojnë çështjet që i mbulojnë dhe audiencën e synuar ose grupin e synuar.

➤ Gjuha

Iniciativat për edukim financiar zbatohen duke përdorur gjuhë dhe terminologji të thjeshtë, të kuptueshme dhe të përshtatshme për publikun e synuar. Gjithashtu,

gjuha dhe mënyra e paraqitjes së përmbajtjeve edukative duhet të përshtaten me karakteristikat specifike të grupeve të personave me nevoja të veçanta.

➤ Përmbajtja

Përmbajtja e iniciativave dhe aktiviteteve për edukim financiar, në thelb, duhet të shpjegojë temën e mbuluar dhe të lehtësojë kuptimin e saj, duhet të përshtatet me karakteristikat e publikut të synuar.

Përmbajtja e iniciativave për edukim financiar duhet të përcaktohet qartë si material për edukim financiar dhe i ndryshëm nga përmbajtjet reklamuese ose komerciale. Rrjedhimisht, çdo përmbajtje që synon të promovojë produkte dhe shërbime financiare, drejtpërdrejt ose tërthorazi, do të konsiderohet si përmbajtje reklamuese ose komerciale.

Iniciativat dhe aktivitetet e ndërmarra për edukim financiar duhet të ndahen plotësisht nga fushatat komerciale ose reklamuese.

➤ Bashkëpunimi

Përderisa ofruesi i edukimit financiar zbaton aktivitete për edukim financiar në shkolla ose fakultete, ai duhet të sigurojë që aktivitete të tilla të kryhen nën mbikëqyrje dhe në bashkëpunim me stafin mësimdhënës të institucionit përkatës mësimor.

➤ Përdorimi i logos ose markes

Institucionet jofitimprurëse që janë ofrues të edukimit financiar mund të përdorin logon ose markën e tyre brenda iniciativave dhe aktiviteteve për edukim financiar që

ata zbatojnë. Sidoqoftë, ky përdorim duhet të jetë i balancuar dhe i përshtatshëm, me qëllim të vetëm për identifikim të ofruesit për edukim financiar.

Institucionet fitimprurëse që janë ofrues të edukimit financiar duhet të përmbahen nga përdorimi i markës së tyre në kuadër të iniciativave dhe aktiviteteve për edukim financiar. Nëse ofruesi për edukim financiar i përket një organizate/shoqate, ajo mund të përdorë logon e saj ose të organizatës, me kusht që ky përdorim të jetë i balancuar dhe me qëllimin e vetëm të identifikimit të organizatave/shoqatave, dmth ofruesit specifik për edukim financiar.

VI. LIGJËRUES PËR EDUKIM FINANCIAR

Të gjithë personat, të cilëve ofruesi për edukim financiar u beson detyrën e prezentimit dhe transmetimit të edukimit financiar, qofshin të punësuar, vullnetarë apo staf i jashtëm (në tekstin e mëtejshëm: trajnerë për edukim financiar), duhet të posedojnë kualifikime specifike, relevante dhe të vlefshme, si dhe të pajisen me burime adekuate që do t'u mundësojnë atyre të zbatojnë në mënyrë efektive edukimin financiar.

Trajnerët për edukim financiar duhet të harmonizojnë trajnimet e tyre me programin arsimor që duhet të ligjerojnë dhe të harmonizojnë prezantimin e tyre mbi temën e mbuluar me parimet e përcaktuara në këtë kod.

Kur marrin pjesë në iniciativa dhe aktivitete të edukimit financiar, trajnerët për edukim financiar duhet të identifikohen si personel që vepron në emër të institucionit që siguron edukim financiar (pavarësisht nga veprimi primar i institucionit).

VII. INFORIMIM RETH INICIATIVAVE PËR EDUKIM FINANCIAR

Ofruesit e edukimit financiar, të përcaktuar në pjesën e III, për secilën iniciativë të caktuar për edukim financiar duhet të informojnë rregullatorin financiar të fushës përkatëse duke paraqitur në mënyrë elektronike formularin në Shtojcën 1, para fillimit të aktivitetit. Formulari përmban të dhëna për qëllimin, temat e mbuluara, grupin e synuar, trajnerët për edukim financiar, kohëzgjatjen e edukimit financiar dhe të tjera. Ofruesit e edukimit financiar janë përgjegjës për të dhënat në formular.

VIII. VLERËSIM I INICIATIVAVE PËR EDUKIM FINANCIAR

Për të përcaktuar efektivitetin e iniciativave dhe aktiviteteve të edukimit financiar që zbatohet, ofruesit e edukimit financiar periodikisht duhet të vlerësojnë dobinë e tyre, duke përdorur metoda të përshtatshme për llojin e iniciativës. Këto metoda duhet të mundësojnë që rezultatet e marra të krahasohen me qëllimet e përcaktuara më parë në mënyrë të bëhen korrigjimet e duhura në programet arsimore, nëse është e nevojshme. Këto metoda vlerësimi të shërbimeve mund të përfshijnë: tregues

sasiorë për implementim (numri i pjesëmarrësve, vizita në uebfaqe), pyetësorë për testimin e njohurive, sondazhe të kënaqësisë, etj.

Pas përfundimit të aktivitetit, ofruesit e edukimit financiar duhet të informojnë rregullatorin financiar nga fusha përkatëse në lidhje me vlerësimet e aktiviteteve të zbatuara, duke paraqitur formularin të Shtojcës 2 në mënyrë elektronike. Formulari përmban të dhëna për mënyrën e vlerësimit të programeve arsimore dhe vetë vlerësimin. Ofruesit e edukimit financiar janë përgjegjës për të dhënat në formular. Rregullatori financiar përfshinë të dhënat nga formulari i dorëzuar në informacionin hyrës mbi aktivitetet e zbatuara të edukimit financiar për segmentin përkatës të tregut për përgatitjen e Raportit Vjetor të Trupit koordinues për edukim financiar dhe përfshirje financiare.

IX. INTERPRETIM I KODIT

Të gjitha çështjet në dalin nga interpretimi i këtij Kodi do të zgjidhen në bashkëpunim me rregullatorin financiar kompetent për segmentin përkatës të tregut në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

SHTOJCA 1

Shtojca 1. Formular për paraqitjen e një iniciativës për edukim financiar	
1. Emri dhe mbiemri, funksioni i parashtruesit të iniciativës	
-	
2. Detajet për kontakt (nr. telefoni dhe e-adresa) e parashtruesit të iniciativës	
-	
3. Emri i organizatës – parashtruesit të iniciativës	
-	
4. Emri i iniciativës/projekt për edukim financiar	
-	
5. Qëllimet e iniciativës	
-	
-	
6. Grupi i synuar sipas grup-moshës	
<input type="checkbox"/> Popullata e re deri në 22 vjet	
<input type="checkbox"/> Popullata e rritur mbi 22 vjet	
<input type="checkbox"/> Popullata e moshuar 64+ _____	
6.a. Në rastin e popullatës së re, a përfshihet sektori i arsimit në iniciativë?	
<input type="checkbox"/> Po	
<input type="checkbox"/> Jo	
6.b. Grupi i synuar sipas sektorit të arsimit (nëse është përgjigjur me PO në pyetjen e më lartë)	
<input type="checkbox"/> Arsimi parashkollor	
<input type="checkbox"/> Arsimi fillor	
<input type="checkbox"/> Arsimi i mesëm	
<input type="checkbox"/> Arsimi i lartë	
6.c. Emri i institucionit arsimor pjesëmarrës në iniciativë (lidhur me pyetjen e më lartë)	
-	
-	
7. Grupi i synuar sipas gjinisë, statusit shoqëror dhe statusit tjetër	
<input type="checkbox"/> Gra	
<input type="checkbox"/> Të papunë	

<input type="checkbox"/> Sipërmarrës <input type="checkbox"/> Sipërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme <input type="checkbox"/> Popullatë rurale <input type="checkbox"/> Të tjera (romët, persona me nevoja të veçanta, etj) _____
8. Numri i planifikuar i pjesëmarrësve direkt në iniciativë
-
9. Të dhëna për ligjëruesit
a. Emri dhe mbiemri _____ Arsimimi _____ Përvoja e punës (institucioni, vitet e përvojës së punës, ndjekja e trajnimeve për edukim financiar) _____
b.
c.
-
10. Tema e ligjëratës/ve (nëse janë të përfshira ligjerata edukative)
-
-
-
11. Kohëzgjatja e iniciativës - periudha (nga/deri)
-
-

SHTOJCA 2

Shtojca 2 - Formular për vlerësimin e iniciativës së zbatuar për edukim financiar
1. Emri dhe mbiemri, funksioni i parashtruesit të vlerësimit
-
2. Detajet për kontakt (nr. telefoni dhe e-adresa) e parashtruesit të vlerësimit
-
3. Emri i organizatës – parashtruesit të vlerësimit
-
4. Emri i iniciativës për edukim financiar në bazë të së cilës kryhet vlerësimi
-
5. Cilat qëllime u arritën pas zbatimit të iniciativës? A ka ndonjë qëllim që nuk është arritur dhe pse?
- - -
6. Numri i planifikuar i pjesëmarrësve direkt në iniciativë
- -
6.a. Nga ato: numri i grave:
7. Numri i pjesëmarrësve indirekte në zbatimin e iniciativës (përmes kanaleve të tjera, rrjeteve sociale, vizitave në uebfaqe)
- -
8. A u zbatuan pyetësorë për nivelin e njohurive dhe vlerësim të aktivitetit të zhvilluar nga pjesëmarrësit pas realizimit të iniciativës?
<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo Nëse po, listoni rezultatet bazë: _____ _____
9. Të dhëna/statistika shtesë për vlerësimin e iniciativës së zbatuar (nëse nuk janë përfshirë në pjesën e mëparshme)
- -